

**STATUT
i shoqerise "Bran Development" sh.p.k.**

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Shoqeria me perjegjesi te kufizuar "Bran Development" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluar dhe nenshkruar nga ortakui saj bazuar ne "Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot, më 15/07/2019Une, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Shoqeria do te emerohet "Bran Development" sh.p.k.

Themeluesii shoqërisë eshte:

1.- Z. Gerti NUSHI, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 23.11.1985, mbajtes i kartes se identitetit me numer 028206513 dhe nr. Personal I51123043B madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise qe perbejne 100% te kapitalit.

NENI 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Kryerja e veprimtarive tregtare ne fushen e ndertimit,per prodhim dhe shitblerje te materialeve te ndertimit. Kryerja e aktivitetit per investimin ne fushen e ndertimit, ne komplekse civile,turistike,industriale, sociale, komplekse te tregimit dhe te sherbimit, bar, restorant, hoteleri etj. Pjesemarrje ne projekte ndertimore si sipermarres, investitor, konsulent, si dhe marrjen persiper te menaxhimit te tyre ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

Investimi me pjesemarrje ne kuota. Ofrimi i sherbimit te konsulences, ne fushen e biznesit, manaxhimit, taksave, etj.

Ndermjetesimi per shitjen dhe marketimin e pasurive te paluajtshme dhe aseteve te ndryshme. Sherbime konsulence ne fushen e menaxhimit dhe marketimit te produkteve rezidenciale, komerciale dhe aseteve. Sherbime marketing, ekspertize shitje, menaxhimi i prones, ndermjetesim qiradhenie, sherbime te studimit te tregut. Veprimitari ekonomike ne fushe e real estate (pasurive te paluajtshme). Negocime, ndermjetesime, perfaqesime te te treteve ne fushen e real estate si ne tregun e brendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Shitje, blerje, dhenie me qira te te gjitha llojeve te pasurive te paluajtshme, brenda dhe jashte vendit, si dhe cdo transaksion tjeter ne funksion te perm bushjes se objektit te veprimitarise ne fushen e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe cdo veprim tjeter i ligjshem qe ka te beje me pasurite e paluajtshme.

Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore si vijon: ndertime me karakter civil dhe ekonomik, punime/germime dhe sistemime dhei, tarracime terrenesh; rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike,veshje fasadash,ndertime urash dhe konstruksione metalike,montime panelesh,ndertime rrugesh,asfaltime,hapje kanalesh si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik.

Import-export dhe shitblerje me shumice dhe pakice te lendeve te para e materialeve te ndertimit si dhe cdo material tjeter te nevojshem per realizimin e qellimit te prodhimit ne perputhje me ligjislacionin shqiptar ne fuqi. Ngarkim-shkarkim, magazinim, transport te mallrave per vete shoqerine dhe per te trete si dhe cdo aktivitet tjeter qe lidhet dhe eshte i nevojshem per objektin e mesiperm. Shitje-blerje pasuri te patundshme etj si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar nga legjislacioni ne fuqi.

NENI 3 ADRESA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete Seline e saj ne adresen: Tirane, Pajtoni Business Center, Kati 5, Rr industriale dytesore midis Wolksvagen dhe Tregut Agro Tregtar,Mezez, Tiranë, Shqipëri.

Veprimitaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar,periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë dhe i konvertuar ne 1 kuote me vlore 100,000 leke (njeqind mijë leke) secila. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku Z. Gerti NUSHI: Zoterues i 1 (nje) Kuote me vlerë 100,000 leke (njeqind mijë leke) secila, që ne total përbajne 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Mbledhja e asamblese se ortakeve eshte organi vendimmarres per rritjen dhe zvogelimin e kapitalit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë, por vete ortaku pranon rivlersimin e pjeses se tij takuese ne shoqeri ne porpcion me rritjen e kapitalit .

Zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE, DREJTUESE DHE STRUKTURORE TE SHOQERISE

NENI 8

ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e me poshteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Administratori

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të

autorizuar;

dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;

e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;

g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Ortaket mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord,

për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10 KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51% pér qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se tre te katertat ose 75% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

NENI 11 MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. pér ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, pér çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 12 PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

NENI 13 ADMINISTRIMI

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë per nje afat 5 vjecar nga data e rregjitimit te kesaj shoqerie prane QKB-se.

- **Z.Gerti NUSHI** shtetas shqiptar, lindur ne Tirane me date 23.11.1985 mbajtes i kartes se identitetit me nr.028206513 dhe nr. Personal I51123043B madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e shoqerise.

NENI 14 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte organi drejtuesi i shoqerise i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme, te kryeje te gjitha veprimet bankare me cdo banke te nivelit te dyte, pa asnje kufizim ;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, te nenshkruaje kontrata ,noteriale ose jo, apo cdo lloj akti tjeter te domosdoshem qe lidhet me aktivitetin e shoqeriser pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; 5
- d) përgatisi dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- f) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; si dhe te kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori eshte I detyruar te therasi Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas

dispozitave ligjore në fuqi.

KREU IV

VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 15 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

NENI 16 EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe tē kontrolloje tē gjithe dokumentacionin kontabel tē veprimtarise ekonomiko tregtare tē shoqerise, ate gjithevetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje tē tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim tē kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit tē bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e tē drejtës vendimore qe ka.

KREU V

PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 17 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim tē Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;

d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoperi ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 18

RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 19

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

NENI 20


MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lind

midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

Gerti Nushi



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Gerti Nushi". The signature is fluid and cursive, with "Gerti" on top and "Nushi" below it, with some additional strokes underneath.